



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 22 maj 2015
Nr. ref.: RK 795/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI171/14

Parashtrues

Agim Vuniqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Ministrisë së Punës dhe
Mirëqenies Sociale/Departamentit të Pensioneve, nr. 919,
të 24 tetorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Agim Vuniqi me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), në emër të prindërve të tij z. Hafir Vuniqi dhe znj. Qamile Vuniqi, me vendbanim të njëjtë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Njoftimi [nr. 919] i Departamentit të Pensioneve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: Departamenti i Pensioneve) i 24 tetorit 2014, me të cilin ishin njoftuar prindërit e parashtruesit të kërkesës se pagesa e pensioneve është suspenduar për shkak të mospërbushjes së kushteve formale.
3. Njoftimi i është dorëzuar prindërve të parashtruesit të kërkesës, më 4 nëntor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës nuk i përmend nenet konkrete, të Kushtetutës, të cilat mund të jenë shkelur.

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113. (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 26 nëntor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 8 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 23 janar 2015, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Departamentit të Pensioneve. Më 28 janar 2015, Gjykata pranoi përgjigje nga Departamenti i Pensioneve.
9. Më 23 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të paraqes në Gjykatë autorizimin, me të cilin z. Hafir Vuniqi dhe znj. Qamile Vuniqi e autorizojnë djalin e tyre z. Agim Vuniqi që t'i përfaqësojë ata në Gjykatë.
10. Parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë përgjigje.
11. Më 15 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në një datë të pacaktuar në vitin 2002, Departamenti i Pensioneve e miratoi pensionin bazë për prindërit e parashtruesit të kërkesës. Prindërit e parashtruesit të kërkesës e kanë pranuar rregullisht pensionin deri në tetor 2013, kur pagesa e pensioneve të tyre është pezulluar.
13. Më 30 shtator 2014, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Departamentin e Pensioneve, duke kërkuar suspendimin e pezullimit të pagesës së pensioneve dhe pagesën retroaktive për periudhën nga muaji nëntor 2013 e tutje.
14. Më 24 tetor 2014, Departamenti i Pensioneve është përgjigjur se *“meqenëse ju nuk iu keni përmbajtur rregullave ligjore për lajmërim, andaj jeni suspenduar nga pagesa e pensionit ndërsa pagesa e mëtutjeshme zbatohet pasi që ju të lajmëroheni gjegjësisht prej muajit që ju jeni lajmëruar”*.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“konsideroj se gjatë procedimit dhe shpërndarjes së mjeteve janë bërë shkelje drastike ligjore, nuk është përcjellur linja buxhetore, mjetet e dedikuara për pensionistët, rasti konkret i nënës dhe babait tim, Qamile dhe Hafir Vuniqi, ato janë ndaluar dhe konfiskuar në mënyrë të panatyrshme nga xhepi i tyre”*.
16. Parashtruesi i kërkesës kërkon *“që të kthehet dinjiteti dhe të vendoset ligjshmëria që pensionistëve Qamile dhe Hafir Vuniqit t’u kthehet buzëqeshja, të paguhen për dy muajt nëntor dhe dhjetor 2014, duke përfshirë edhe kamatat komerciale”*.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (1). të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

19. Neni 21 i Ligjit, gjithashtu përcakton se:

“Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala”.

20. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar.

21. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar autorizimin e kërkuar me të cilin prindërit e tij z. Hafir Vuniqi dhe znj. Qamile Vuniqi, do ta autorizonin parashtruesin e kërkesës që t'i përfaqësojë ata në Gjykatë.
22. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është “palë e autorizuar” as në cilësinë personale, as si përfaqësues i autorizuar i prindërve të tij.
23. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk mund të shqyrtohet dhe, në pajtim me nenin 113. (1) të Kushtetutës, nenin 21 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 21 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 maj 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani